



Zbatimi i detyrimeve mjedisore të guroreve dhe praktikave të mira për kontributin e sipërmarrjeve në komunitet

Përgatitur nga Endri Haxhiraj, Ekspert mjedisor
Shtator 2022

Hyrje

Guroret përbëjnë sot në Shqipëri një aktivitet minerar shqetësues për mjedisin, për burimet ujore dhe për shëndetin njerëzor. Nga shumë raportime, vërejmë se në të gjithë Republikën e Shqipërisë kemi fenomene të ndryshimit të theksuar të relievit ¹ nga njëra anë, por edhe të erozionit ², dhe ndotjes së ujërave dhe ajrit ³. Guroret i gjejnë edhe në zona të mbrojtura ⁴, ku që mund të kenë pasoja mjedisore edhe më të rënda.

Guroret përbëjnë një faktor kryesor të çlirimit të grimcave të imta që janë burimi

kryesor i ndotjes së ajrit në zonat e banuara duke ndikuar në shfaqjen e shumë gjendjeve shëndetësore, që nga kollë dhe ftohje, inflamacion të hundës, astmë, dëmtim i dëgjimit për shkak të ndotjes së zhurmës, stres ⁵ dhe deri tek shfaqje e sëmundjeve tumorale ⁶. Zhvendosja e detyruar e banorëve për shkak të këtyre problemeve ngre gjithashtu edhe një çështje sociale. Në këtë linjë, një tjetër faktor është i prekshëm, shmangia e dëgjësave transparente me publikun dhe parashikimeve të Konventës së Aarhusit, qasja në informacion, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe akses në

¹ <https://ina.media/?p=2626>

² <https://www.beep.ac.uk/content/231.0.html>

³ https://www.ecoalbania.org/wp-content/uploads/2019/11/Raport-MECA_ALB.pdf, faqe 7.

⁴ <https://www.reporter.al/2021/05/11/guroret-e-tomorrit-kthehen-ne-burim-aksidentesh-te-renda-per-punetoret/>

⁵ <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/cgi/viewcontent.cgi?article=3411&context=etd>

⁶ https://www.acnss.com/wp-content/uploads/2020/06/Policimi_dhe_siguria_nr_19.pdf

drejtësi për çështjet mjedisore. Sipas studimeve, aktiviteti minerar paraqet edhe ndikim në çlirimin e gazave serë me ndikim tek ndryshimet klimatike⁷.

Mosrehabilitimi i mjedisit të dëmtuar nga guroret mbetet ndër pikat më problematike të guroreve, megjithëse është detyrim ligjor. Në shumicën e rasteve, ky detyrim nuk zbatohet. Madje raportohet se është buxheti i shtetit ai që në shumë raste kryen rehabilitimin⁸ pas braktisjes së guroreve megjithëse e ka detyrim ai subjekt që ka dëmtuar mjedisin me anë të gurores. Fenomeni i mos rehabilitimit është përmendur që në krye të herës në vitin 2018 nga kryeministria⁹ dhe kjo dëshmon se të gjithë palët janë të dëmtuara njëllë nga operimi pa i zbatuar detyrimet ligjore të guroreve.

Problematika

Një ndër problemet më aktuale është ndotja nga pluhuri që shkaktojnë guroret. Subjektet që operojnë në gurore janë të detyruara që të bëjnë vetë matjet për shkarkimet apo ndotjet¹⁰ që shkaktojnë dhe më pas rezultatet e matjeve duhet t'i dorëzojnë te Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Edhe pse një veprimtari guroreje ka potencialisht ndikim në mjedis për efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore dhe me qëllim për të parandaluar këto fenomene, Ligji parashtron qartë detyrimin e një subjekti për të kryer vlerësimin e ndikimit në mjedis¹¹. Duke parë ndotjen që guroret kanë shkaktuar, duket se respektimi i VNM-ve nuk është real.

Në Planin e Veprimit të guroreve (Pika 10) parashikohet se pastrimin e sheshit nga vegetacioni të kryhet në mënyrë progresive (vit pas viti), në varësi të zonës së punës dhe jo e gjithë sipërfaqja që në vitin e parë, për të reduktuar ndikimin në vegetacion dhe impaktin vizual¹². Pamjet e zakonshme të guroreve në fakt lënë për të dëshiruar, duke shkatërruar peizazhin dhe duke kërcënuar shpesh edhe turizmin në zonë.

-Guroret mund të ndikojnë potencialisht në faunën dhe florën e një zone, duke prerë bimësi të rëndësishme dhe duke shkatërruar habitet e specieve të ndryshme. Ligji e përcakton qartësisht që para fillimit të punimeve të shfrytëzimit, subjekti duhet të evidentojë speciet,

⁷ <https://sciendo.com/pdf/10.1515/rtuect-2017-0011>

⁸

<https://www.youtube.com/watch?v=iqKtbkBK79Q>

⁹ <https://www.kryeministria.al/newsroom/planet-e-zhvillimit-per-qarkun-e-beratit/>

¹⁰ Neni 44 pika 1,2,3,4, Ligji 10431, datë 09.06.2011, fq. 15

https://ikmt.gov.al/images/legjisllacioni/Ligji_nr_1_0431_dat%C3%AB_9_6_2011_P%C3%ABr_mbroitjen_e_mjedisit.pdf

¹¹ ligji 10431 dt 09.06.2011për Mbrojtjen e Mjedisit, Neni 25, pika 1,2,3,4 fq. 9

¹² Urdhër Nr. 67, datë 11.03.2018

bimësinë reale që do të preket nga shfrytëzimi e cila do të rehabilitohet më pas¹³. Peizazhet malore qoftë edhe të mbrojtura shpesh gjenden të pambrojtura nga moszbatimi i ligjit.

Janë evidente në çdo cep të vendit guroret e braktisura dhe të parehabituara edhe pse ligji përcakton që reabilitimi duhet të kryhet çdo vit që në vitin e parë¹⁴ duke marrë edhe miratimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Konsultimet me komunitetin me subjektet e aktivitetit gurore janë ndër problematikat më të theksuara në vend. Shumë banorë e gjejnë veten përballë një fakti të kryer që kërcënon qëndrimin e tyre në zonë ose kërcënon aktivitete jetike të tyre. Ligji parashikon që konsultimi dhe hapja e rrugëve të komunikimit të cilat mund t'i shërbejnë për qëllime të tjera edhe komunitetit¹⁵ përreth. Shpesh banorët indinjohen si banorë autoktonë duke mos qenë të dëgjuar.

Përqindja e vlerës së mineralit të shitur (ose renta minerare¹⁶, duhet t'i paguhet shtetit nga zotëruesi i lejes minerare (në rastin tonë të gurores) si kompensim për zvogëlimin e burimeve minerare, por ka indikacione se ajo paguhet nga vetëm një pjesë e subjekteve¹⁷. Ligji parashikon revokim të lejes¹⁸ kur zotëruesi nuk paguan rentën minerare sipas afateve të legjislacionit në fuqi.

¹³ Pika 9 për miratimin e “planit të veprimit për veprimtaritë minerare me karrierë (guroret)” fq.3922 në Urdhër Nr. 67, datë 11.03.2018


¹⁴ pika 8 Urdhër Nr. 67, datë 11.3.2018

¹⁵ Urdhër Nr. 67, datë 11.3.2018

-Megjithëse bashkitë janë ato që humbasin territor dhe mbartin ndotjen e shkaktuar nga guroret, ato nuk janë të lejuara me ligj që të vendosin taksa shtesë mbi guroret për të kompensuar ndotjen dhe shkatërrimin që po i bëhet territorit të tyre e komuniteteve që jetojnë në këtë territor. Paratë që u ndahen bashkive nga qeveria qendrore nga renta minerare, nganjëherë janë në shumë qesharake, si në rastin e Kukësit kur në një vit kjo bashki mori gjithsej 340 lekë rentë minerare megjithëse shkatërrimi nga guroret në këtë bashki është shumë i dukshëm.

Kuadri ligjor

Ligji Nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” është ligji që parashikon edhe veprimtarinë e guroreve. Lidhur me aktivitetin minerar ka 12 Vendime të Këshillit të Ministrave, 19 Urdhra të Ministrit, Ligji, Vendime të Këshillit të Ministrave dhe urdhëresat për mbrojtjen e mjedisit, Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat Kombëtare” dhe Ligjet për



Harta Dixhitale e aktivitetit minerar në Shqipëri. Burimi AKBN

¹⁶ Ligj nr.10 304 datë 15.7.2010

¹⁷ media <https://www.youtube.com/watch?v=iqKtbkBK79Q>

¹⁸ neni 47, Ligj nr.10304 datë 15.7.2010

sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve.

Duket se me ligjin qëndron zgjidhja dhe njëkohësisht edhe problematika e fenomenit negativ të guroreve. Është ligji ai që detyron çdo gurore të sigurojë kushtet për të parandaluar pluhurat që ngrihen gjatë aktivitetit¹⁹ por nga ana tjetër dallohet lehtësisht se kjo nuk gjen zbatim dhe penalitetet e parashikuara nuk po reflektojnë ndryshim të gjendjes. Duke qenë se administrata ligjzbatuese ka një kakofoni kompetencash ligjore edhe kontrollet dhe penalitetet janë të kufizuara duke mos e kufizuar ndotjen.

-Presion në kompetenca ligjore

Sipas parashikimit ligjor²⁰ leja minerare jepet nga Qendra Kombëtare e Licencimit. Këshilli i Ministrave vendos për dhënien e lejes, sipas ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009. Më pas Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nën varësinë e Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturës, shqyrton dhe vlerëson plotësimin e kushteve të dhënies së lejes së shfrytëzimit dhe dokumenteve vërtetuese për kërkesat për zonat e hapura dhe ato përmes procesit të konkurrimit dhe gjithashtu administron ekskluzivisht të gjitha të dhënat parësore që lidhen me veprimtarinë minerare dhe post-minerare. Nga ana tjetër është Agjencia Kombëtare e Mjedisit nën varësinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, institucioni që monitoron lejet mjedisore dhe ndikimin në

mjedis, e cila gjendet në presion e përpara faktit të kryer.

Rekomandime

- Përpara fillimit të një aktiviteti minerar në sektorin e guroreve, çdo subjekt duhet të orientohet nga entet liçensuese se ai duhet të konsiderojë si prioritet: Ndotjen nga pluhuri që shkakton ky aktivitet, Ndikimin në mjedis, tek flora, fauna dhe pamja vizuale, të konsiderojë ankesat e komunitetit, dhe rentën minerare si proces kyç në veprimtari dhe rehabilitimin përfundimtar të gurores.
- Ruajtja e mjedisit dhe shëndetit publik nga aktiviteti i guroreve duhet të garantohet me zbatim të përpiktë të legjisllacionit në fuqi. Fokus të veçantë duhet të marrë parandalimi i dëmit mjedisor dhe rrezikimit të shëndetit.
- Informimi paraprak i banorëve, transparenca me komunitetin dhe dëgjuesat me të duhet të marrë një rëndësi prioritare sikurse parashikon konventa e Aarhusit. Edhe ligji e parashikon tashmë se konsultimi dhe dëgjuesat duhet të fillojnë që në fazën para ngritjes së sheshit të kantierit lidhur me pretendime apo ankesa që mund të kenë lidhur me ndikimet e pritshme për të reduktuar kostot më pas. Zbatimi i ligjit është zgjidhja më e mirë e rekomanduar për këtë qëllim.

¹⁹ Ligji nr 47 dt 11.03.2008

²⁰ Ligji nr 10304, dt.15.07.2010 Neni 30 Procedurat e dhënies së lejeve minerare

- Monitorimi i zbatimit të legjislacionit veçanërisht për sa i përket emetimeve të pluhurave dhe rehabilitimit duhet të jetë objektiv parësor i enteve ligjzbatuese. Në këtë kuptim duhen rishikuar edhe kontratat nëse kanë janë përmbushur kërkesat e saj apo jo. Ndjekje e vazhduar e zhvillimit të punës pranë guroreve nga institucionet përkatëse, duke parandaluar shmangien ndaj ligjit dhe thellimin/zmadhimin e problemeve (përmbajtja e planit të veprimit) sikurse parashikon ligji nr 10431 dt 09.06.2011 neni 63. Agjencitë ligjzbatuese, AKM dhe AKBN duhet të kenë kompetenca të rregulluara qartë në mënyrë që edhe ligji të zbatohet sipas parashikimit.
- Bashkitë duhet të jenë palë me komunitetin për ta përkrahur atë në kushtet e një presioni nga aktivitetet e guroreve, për të mbrojtur banorët nga problemet sociale.
- Bashkitë duhet të lejohen me ligj që të vendosin taksa mjedisore për guroret në territorin e tyre, dhe të përdorin këto të ardhura për të zbutur dëmin që shkaktojnë guroret.
- Kryerja në mënyrë permanente e matjeve të shkarkimeve nga institucionet shtetërore (në këtë rast AKM) dhe jo t'i lihet vetë subjekteve ta bëjnë një gjë të tillë. Ndotja e ajrit por jo vetëm është ndër problemet më të mëdha të shkaktuara nga guroret dhe kontrolli i këtyre matjeve nga institucionet shtetërore do sillte menaxhim më të mirë të të gjithë linjës së punës nga këto subjekte, duke filluar nga mjetet e punës e deri te rregullat gjatë punës.
- Penalitete më të forta për shkeljet ligjore, në bazë të shkeljes, dhe heqje të licencës (revokim të lejes) në rast përsëritje të shkeljeve ligjore. Si për çdo subjekt që ushtron veprimtari në burimet natyrore të vendit tonë, renta minerare duhet mbledhur me përpikëri edhe për aktivitetin e guroreve.
- Detyrimi nga institucionet që të zbatohet ligji në rastin e mosrehabilitimit të gurores pas përfundimit të veprimtarisë në lotet e caktuara. Në rast se institucionet nuk veprojnë, duhet të penalizohen dyfish si subjekti i gurores që nuk e ka rehabilituar guroren, ashtu dhe institucioni që nuk ka kryer kontroll dhe nuk ka detyruar subjektin që të rehabilitojë dëmin e shkaktuar.



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efektive përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H.1, 1017, Tirana | T +355 4 240 0241 | info@idmalbania.org



[/company/idm-albania](https://www.linkedin.com/company/idm-albania/)



<http://www.idmalbania.org/>



[/idm_albania](https://twitter.com/idm_albania)



[/IDMAlbania](https://www.facebook.com/IDMAlbania)

Projekt i:



Zbatuar nga:



Pikëpamjet dhe përfundimet që jepen në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe të NDI – Institutit Demokratik Amerikan. Autorësia e këtij botimi i përket vetëm IDM-së.